



## Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor në fshatin Dajkoc

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

### Publikimet:

### UEBFAQE:

### FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=884311700397830&set=pcb.884319097063757>

### PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:

Me 05.07.2024 dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Dajkoc duke filluar nga ora 19:00.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Derjtori për Investime Kapitale, Blerim Murina, Drejtori i Urbanizmit, Uran Berisha, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, banorë të fshatit Dajkoc.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqësin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shumë të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojm një draft buxhet për vitin e

ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro ku do të ketë një rritje prej 5.2%, krashasuar me vitin 2024, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioritetëve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishmë në fshatin Dajkoc.

Më pasë Zëdhënsja e Komunës, Lidiona Marovca, ka prezantuar punët që janë bërë vitin e kaluar: dy student kanë fituar burë për student nga fshati juaj, transporti i nxënësve nga fshati Dajkoc dhe Muqiverc, lagjja e Brahimve, kyqja nëe ujësjellësit, këtë vitë ka me filluar zgjerimi I rrugës kolloleq, Dajkoc, muqiverc dhe do të asfaltohen këto rrugë: asfaltimi I rrugës “Shaban Syl Krasniqi”, asfaltimi I rrugës “Nebiu” , rr. “Ali e Zylfi Fazliu”, rr. “Xhafer e Nevzad Krasniqi”, rr. “Rexhep Shem Dajkoci”, degëzimi 2 dhe asfaltimi I rr. “Musli Dajkoci”, janë rrugët të cilat kanë hy në buxhet, tash janë edhe në procedurë të prokurimit dhe janë rrugët të cilat do të shreohen për gjatë këtij viti në Dajkoc.

#### **Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:**

Banori Shefqet Krasniqi: kërkesat tona janë shumë të mdhaja, mirëpo nuk e di sa jan mundësit me na ndihmu, së pari janë rrugët, rryma, dhe disa rrugë që na lidh me fshatin Bllat 300metra gjatësi, si dhe degëzimi i rrugës “Sylë Ramë Dajkoci” me gjatësi 55metra.

Banori Dilaver Krasniqi: “Sylë Ramë Dajkoci”, e lidhe Kolloleqin me Dajkocin dhe Muqivercin është rrugë e rrezikshme sepse rrëshqet dheu nga reshjet. Ne ju kemi bërë kërkes, mirëpo nuk na keni kthyer përgjigje.

Drejtori Uran Berisha: rruga që e përmende që lidhe Kolloleqin me Dajkocin dhe Muqivercin, ne po shpresojm që në vitin e ardhshëm ministria të na përkrah projektin, sepse ky projekt është madhor dhe ne si komun nuk mund ta mbulojmë, mirëpo do të bashkëpunojm me ministrin dhe do të mundohemi që të përfundohet.

Banori : Nga qendra kan thënë se sivjet kjo rrugë që lidh me fshatin e Bllatës, ka me u shtruar, mirëpo nuk është marë asnjë masë që të shtrohet.

Banori Hajdar Krasniqi: në fshatin Dajkoc nuk ka fushë të futbollit, kërkoj një fushë sportit.

Banori : a e keni pyet fshatin që të ndërtohet kuzhina popullore në këtë vend të shkollës?, ne si mërgimtar me bashkëfshatar kemi investuar vetë për këtë shkollë.

Drejtori: komuna kur e ka mbyll shkollën e ka marë përsipër me i bajt nxansat. Ne planin për kuzhinën popullore e kemi pasë me ndërto në Kamenicë, mirëpo meqë kjo shkollë nuk është funksionale e kemi vendosë me prurë në Dajkoc.

Banori Hajriz Krasniqi: fshati jonë ka nevoj për trajtimin e ujrave te zeza. Ne I kemi do kanalizime qka i kemi ndërto vetë privat, janë gypat e vogël, një reshje shiu I bllokun

kanalizimet dhe uji na kalon nëpër shpija tona, nëse ka mundësi komuna të na dërgojn disa gypa ma të mdhaj, duhet të shtrihen gypa të ri.

Banor Xhevdet Krasniqi: në rrugën “Syl Dajkoci” janë 6 familje dhe ka nevoj shumë që të asfaltohet 55m.

Banori Naim Krasniqi: ndriqimi i rrugës Dajkoc -Muqiverc, si dhe mirmbajtja e rrugës Gradevci.


	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Shefqet Krasniqi	Rruga e fundit qe lidh me fshatin Billatë 300m, Degëzim I rrugës “Syl Ram Dajkoci” 55m.	Me telefon
2.	Dilaver Krasniqi	Asfaltimi I rrugës “Syl Ram Dajkoci”	Me telefon
3.	Banori	Rregullimi dhe asfaltimi I rrugës që lidhë me Billatën	Me telefon
4.	Hajdar Krasniqi	Rregullimi I një fushe të sportit	Me telefon
5.	Hajriz Krasniqi	Ndriimi I gypave të kanalizimit.	Me telefon
6.	Xhevdet Krasniqi	Asfaltim I rrugës “Syl Dajkoci” 55m.	Me telefon
7.	Naim Krasniqi	Shtrirja e ndriqimit public, rr. Dajkoc –Muqiverc, Mirëmbajtja e rruges Gradevci	Me telefon

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 19:35.

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për degjimin buxhetor në Dajkoc

Data: 05.07.2024

Ora: 19:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatesia etnike	Nënskrimi <sup>12</sup>
1.	SHUKRI KENASHI			M		Shukri
2.	Hopit Kadri			M		Hopit
3.	XHEVDET KRASHI			M		Xhevdet
4.	Didar Krasniqi			M		Didar
5.	Aziz Krasniqi			M		Aziz
6.	Shefqet Krasniqi			M		Shefqet
7.	Hekuran Krasniqi			M		Hekuran
8.	Zyrtar Krasniqi			M		Zyrtar

<sup>1</sup> SHQ: Me këtë nënskrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për qdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografise i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

<sup>2</sup> SHQ: Me këtë nënskrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpusoj të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obraduje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Emaili adresa	Gjinia	Përkatesia etnike	Nënshkrimi <sup>12</sup>
9.	Oliver DZARAVIQA			M		
10.	SHEFERI RENKASNIQA			M		
11.	FELH KALASNIQA			F		
12.	IRMET KRASNICA			M		
13.	KUM KRASHIQA 1			M		
14.	LEON KRASNICA			M	SH	
15.	HATDAR KRASHIQA			M		
16.	Felher Jnifi			M	Al.	
17.						
18.						
19.						
20.						
21.						
22.						
23.						
24.						

<sup>1</sup> SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB:** Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografise i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampar.

<sup>2</sup> SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përdorë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.